



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18918 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

VENDIM

Nr. 104 , Datë 23 . 09 .2022

Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; të VKM Nr.412, datë 15.06.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në Bashkitë Kamëz dhe Lezhë”; dhe shkresës së MFE nr.11578/2, datë 23.06.2022 “Mbi zbatimin e VKM nr.412, date 15.06.2022”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

- 1.Miratimin e një shtesedhe ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024, si më poshtë:
 - 1.a-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 15,036,570 lekë dhe për vitet e tjera në shumën 10,024,380 lekë.
 - 1.b-Të shtohet shpenzimet në programin buxhetor “Planifikimi Urban Vendor” për vitin 2022 në shumën 15,036,570 lekë dhe për vitet e tjera në shumën 10,024,380 lekë.
- 2.Veprimet të kryhen si më poshtë :
 - 2.a- Pakësohet : Gr.00, Prog.04960, Kap.01, Art.604 për vitin 2022 në shumën 15,036,570 lekë dhe për vitet e tjera në shumën 10,024,380 lekë.
 - 2.b-Shtohet : Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.606 për vitin 2022 në shumën 15,036,570 lekë dhe për vitet e tjera në shumën 10,024,380 lekë.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





ICB. Prot 15718/
D. 28.9.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 677/4 Prot.

Lezhë, më 28.09.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe VKM nr. 412, datë 15.06.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, në Bashkitë Kamëz dhe Lezhë”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 104, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

